



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 599 Prot.

Tiranë, më datë 26.12.2018

**VENDIM**

**Nr. 517, datë 26.12.2018**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RESTAURIMIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 26.12.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit të restaurimit: “Banesa Tip vilë 2 kate, me një kat papafingo, Rruga “Donika Kastrioti”, Monument Kulture II-029”, kërkesë e Ing. Rest. Fatjon Saliu;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Mirela KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**